URDHËR
Nr. 595, datë 11.12.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Oltjon Muzaka, zëvendësministër, për:

a) nënshkrimin e autorizimit për vendosjen në treg të produkteve biocide apo vendimit për refuzimin e dhënies së autorizimit për vendosjen në treg të produkteve biocide;

b) nënshkrimin e autorizimit të importit për barna narkotike/lëndë psikotrope anglisht/shqip, që i dërgohet paraprakisht vendit eksportues; autorizimit të importit për zhdoganimin e barnave narkotike; autorizimit të importit për zhdoganimin e lëndëve psikotrope; autorizimit të eksportit për barna narkotike/lëndë psikotrope anglisht/shqip, që i dërgohet paraprakisht vendit importues; autorizimit individual të importit/eksportit për lëndët e kategorisë 1/2 anglisht/shqip që i dërgohet paraprakisht vendit eksportues/importues; autorizimit të importit për barnat e dhuruara (dhe/ose kryerjen e provave klinike) dhe autorizimit të importit për prekursorët.

2. Urdhri nr. 511, datë 28.8.2023, "Për delegim kompetence" shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala